Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0604

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani-Kryetarë, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "UNIVERS-M" SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2-1, me 07/12/2023, mori:

Vendim

1. Miratohet, si e bazuar ankesa e OE "UNIVERS-M" SH.P.K., me nr. 2023/0604 , e datës 22/08/2023, kundër "Njoftimit Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a, datës 09.08.2023, për anulimin e aktivitetit të prokurimit" Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2-1 .

2. Anulohet, "Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a, datës 09.08.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit" Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2- dhe aktiviteti i prokurimit publik i AK, kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4.Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE "UNIVERS-M" SH.P.K ,sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me,14.06.2023, "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2-1. Ndërsa me datën 09.08.2023 ka publikuar B58 Njoftimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 45,000.00€.

Me 14.08.2023, OE "UNIVERS-M" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 16.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.08.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "UNIVERS-M" SH.P.K., me nr. 604/23 lidhur me aktivitetin "Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet ankimore të operatorit ekonomik "UNIVERS-M" SH.P.K."

Ankuesi pretendon se, anulimi i aktivitetit te prokurimit nga Autoriteti Kontraktues është bere ne shkelje te nenit 1, nenit 7, nenit 62 te LPP-se, nenit 43(5), (7) te Rregullores për prokurimin publik. Aktiviteti është publikuar me njoftimin për kontrate me date 14.06.2023, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qene data 07.07.2023, ku me datën 07.07.2023 është bere hapja e ofertave dhe përgatitur procesverbali i hapjes ne këtë aktivitet prokurimit kemi qene të vetmit ofertues. Me datë, 14.07.2023 nga Autoriteti Kontraktues (AK) përmes letrës standarde te kërkesës për sqarimin e tenderit janë kërkuar informata sqaruese, ku me date 15.07.2023 është kthyer përgjigjja nga OE "Univers-M" shpk ku është konfirmuar se produktet do te liferohen sipas kushteve të dosjes se tenderit. Me date 09.08.2023 nga Autoriteti Kontraktues është nxjerrë vendimi për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me arsyetimin se njësia kërkuese ka konfirmuar se nevojat e tyre kane ndryshuar nga momenti i inicimit te tenderit prandaj ky aktivitet duhet te anulohet me qellim qe te behën përmasimet e nevojshme. Oferta e ofertuar ne vlerën 33,984.00 € është dukshëm me e ulet se buxheti i parashikuar nga AK ne vlerën 45,000.00€, oferta e ofertuar është me e ulet 24.48% ose 11,016.00€ ne krahasim me buxhetin e planifikuar nga AK. Nuk qëndron asnjë fakt dhe arsye ligjore për anulimin e këtij aktiviteti te prokurimit i parapare me LPP-ne dhe rregulloren për prokurimin publik. Këtu ka indic je për te drejtën qe kërkohet nga OE qe i takon me ligj edhe te behet anulimi i aktivitet vetëm për te mos shpërblyer me kontrate OE "UNIVERS-M SHPK". Duke marre parasysh argumentet, faktet, provat e potencuar dhe arsyetimet e ofruara me arsyetim ligjor dhe pretendimet për dispozitat ligjore te shkelura nga Autoriteti Kontraktues te specifikuara ne piken 7 te kësaj ankese,

Kompania “Univers - M, sh.p.k”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “UNIVERS-M” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 62 të LPP si dhe 43(5) , 43 (7) RRPP ka bere shkelje te dispozitave ligjore te ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (me tej: LPP), Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik (me tej: Rrpp), Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimin Publik. Duke propozuar qe ankesën ta aprovoj si te bazuar ta anuloj vendimin e AK dhe lenden ta kthej ne rivlerësim.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 25/08/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 604/23, ndërsa me datë 31/08/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0604 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, “Autoriteti kontraktues Nuk Pajtohet nuk janë verifikuar mjetet pasi nga njësia kane rekomanduar qe nuk janë te nevojshme për ketë vite me këto furnizime. Ndërsa OE me Pajtohet me raportin e eksperti shqyrtues”

Lidhur me pretendimet e OE “UNIVERS-M” SH.P.K., ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0604 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i Prokurimit me titull ”Furnizim me lidhëse elastike” me nr të prokurimit KEK -23 - 6102 – 121 është iniciuar nga AK- Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, dhe ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 14.06.2023, me procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, kriter i dhënies së kontratës çmimi më i ulët, hapja e ofertave është bërë me datë 07.07.2023, vendimi i AK-së mbi anulimin është publikuar me datë 09.08.2023. Arsyeja e AK-së në vendim mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit është: “KEK anulon aktivitetin e prokurimit pasi qe njësia e kërkuese ka konfirmuar se nevojat e tyre kanë ndryshuar nga momenti i inicimit te tenderit, prandaj ky aktivitet duhet te anulohet me qellim qe te behën përmirësimet e nevojshme*”*

Pas analizimi, krahasimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK pasi ka hapur ofertat, gjatë vlerësimit ka kërkuar sqarime tek OE ankuesi, lidhur me afatin e liferimit të produkteve, ku i njëjti ju ka përgjigjur AK-së në afat, më pastaj ky i fundit pas marrjes së përgjigjes me date 15.07.2023, merr vendim të anuloj aktivitetin e prokurimit me date 09.08.2023. Tutje, pretendimi i OE ankuesit është i qëndrueshëm, për faktin se AK pas hapjes dhe sqarimit së ofertave, konform nenit 62 të LPP-së, nuk mund të anulohet aktiviteti i prokurimit me arsyetim të tillë, për arsye se me date 18.05.2023 është bërë kërkesa për fonde, dhe me datë 07.06.2023 janë siguruar fondet nga ZKF po ashtu me date 08.06.2023 janë aprovuar mjetet nga ZKA, njoftimi për kontratë është bërë me datë 14.06.2023,.

Bazuar në Rregulloren e Prokurimit Publik Nr. 001-2022, nenin43.1 në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikoj Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë. 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave, anulohet për një nga arsyet e mëposhtme: a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar; b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre); d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar; g. asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit; i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi; j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP. Kurse, AK publikon Njoftimin B58 për anulimin e aktivitetit prokurimit, pa e arsyetuar me dispozita ligjore të lartcekura, andaj pretendimi OE ankues është i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "UNIVERS-M" SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertes është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "UNIVERS-M" SH.P.K., janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të LPP si dhe në Rregulloren e Prokurimit Publik Nr. 001-2022, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik është bazuar në ligj. Paneli shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit të Anulohet, "Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a, datës 09.08.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit" Furnizim me lidhëse elastike" me numër të prokurimit KEK-23-6102-1-2- dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim dhe AK të veproj nëpërputhje me dispozitat ligjore të LPP-së, Rregulloren e

Prokurimit Publik Nr. 001-2022,dhe kërkesat e Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se anulimit i këtij aktiviteti të prokurimit më datës 09.08.2023 nga ana e Autoriteti Kontraktues, Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a,, është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Prokurimit Publik ,Nr. 001-2022, nenin43.1, andaj bazuar në fakte dhe argumentet e paraqitura me lart si ky aktivitet i prokurimit kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Lidhur me tarifën është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, Nr.01/2020, lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **" UNIVERS-M " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: